

# SIGURIA NË KOMUNITETIN TONË



Broshurë informimi për  
policimin në komunitet  
në veri të Kosovës



**osce**

Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
OSCE Mission in Kosovo





**Kapiteni Nenad Djurić,**  
**Drejtor i Drejtorisë Regjionale**  
**Mitrovicë - Veriu**

## Hyrje

Në transformimin tonë në vitet e fundit, Policia e Kosovës ka përqaftuar filozofinë e policimit në komunitet – një filozofi që promovon bashkëpunimin dhe ndërtimin e besimit mes popullit dhe policisë. Kjo mënyrë e re e policimit ka të bëjë me zyrtarët e policisë që punojnë në partneritet me banorët për të adresuar çështjet që ndikojnë tek të gjithë ne, siç janë krimi, frika nga krimi, dhe prishja e rendit publik.

Shumë njerëz nuk ndjehen të sigurt. Ne duhet ta ndryshojmë këtë gjendje së bashku. Policia e Kosovës është e vendosur për ta përmirësuar dhe rritur sigurinë në komunitet në veri të Kosovës. Ne do të punojmë me banorët në parandalimin e zvogëlimin e krimit dhe sjelljeve asociale dhe në të njëjtën kohë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e lirinë së lëvizjes.

Njerëzit kanë të drejtë të jetojnë pa pasur frikë nga krimi. Së bashku me komunitetet lokale do të punojmë për ta rritur cilësinë e jetës dhe sigurisë. Në këtë rrugëtim na nevojitet mbështetja e juaj. Tani është koha për ta mbështetur policinë tuaj në ndërtimin e një të ardhmeje që të gjithë e meritojmë



# Çka është policimi në komunitet?

Policimi në komunitet është filozofi dhe një strategji organizative që është e bazuar në përpjekjet e përbashkëta të banorëve dhe policisë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të komunitetit. Siç është përcaktuar nga Sir Robert Peel në vitin 1829, policimi në bashkësi nënkupton “ruajtja në çdo kohë e marrëdhënieve me publikun gjë kjo që e bënë të vërtetë traditën historike ku policia është populli dhe populli është policia: Policët janë thjeshtë pjesëtarë të popullit të cilët paguhën për t’i kushtuar vëmendje gjatë gjithë kohës detyrave të cilat i përkasin çdo banori në interes të mirëqenies dhe ekzistencës së bashkësisë.”

## Filozofia e Policimit në Komunitet

Parakushti kryesor i policimit në komunitet është që niveli i pjesëmarrjes së komunitetit në forcimin e sigurisë dhe rendit social dhe në zgjidhjen e krimit që ndërlihet me komunitetin duhet rritur pasi që policia nuk mund ta përmbushë këtë detyrë e vetme.



Për ta nxitur publikun që ta marrë përsipër pjesën e vet të përgjegjësisë në përmirësimin e cilësisë së jetesës në komunitet duke mbështetur kështu aktivisht përpjekjet e policisë për të kontrolluar dhe parandaluar krimin, policia duhet të ndërtojë besimin dhe zhvillojë partneritet me publikun. Ky partneritet duhet të karakterizohet nga një reagim reciprok dhe nga një pozitë e barabartë për të dy partnerët.

Për ta arritur këtë partneritet, policia duhet të integrohet më mirë në komunitet dhe ta forcojë legjitimitetin e saj në komunitet përmes policimit të bazuar në pëlqim dhe përmirësimit të shërbimit të tyre ndaj publikut. Kështu që policia në komunitet duhet:

- të jetë e dukshme dhe e arritshme për publikun;
- ta njohë dhe të njihet nga publiku;
- t’u përgjigjet nevojave të komunitetit;
- të dëgjojë shqetësimet e komunitetit;
- të angazhohet dhe ta mobilizojë komunitetin;
- të japë llogari për veprimtaritë e saj dhe për rezultatet e këtyre veprimtarive.

Dukshmëria dhe qasja kërkojnë që punonjësit e policisë të jenë lehtësisht të arritshëm për anëtarët e komunitet përmes krijimit të një pranie të dukshme dhe jo kërcënuese në lagjet që mbulojnë. Kontaktet personale të përditshme gjithashtu do të ndihmonin që komuniteti të njihet dhe mësohet me policët e tyre.

Punonjësit e policisë duhet ta njohin përbërjen shoqërore të komuniteteve të tyre. Kështu ata duhet të krijojnë “harta sociale” të lagjeve ku ata janë caktuar, duke renditur, për shembull, banorë dhe grupe të pambrojtura, persona problematikë dhe kriminelë, vatra krimi (p.sh. lokalet) dhe zonat e nxehta, drejtuesit e komunitetit, llojet e bizneseve në zonë dhe objektet shoqërore.





*Reagimi* është një parim themelor i policimit demokratik, që do të thotë se policia u përgjigjet nevojave dhe shqetësimeve (të menjëhershme) të të gjithë anëtarëve të publikut dhe përpjet të japë një shërbim të shpejtë dhe në mënyrë të barabartë e të paanshme, duke treguar ndjeshmëri ndaj atyre në nevojë dhe respekt për të drejtat e njeriut. Shërbimet e tyre duhet të jenë në përputhje me normat dhe vlerat e komunitetit dhe me nevojat individuale të pjesëtarëve të komunitetit ku policia vepron.

Koncept kryesor në policimin në komunitet është *'konsultimi me komunitetin'*. Nevoja për konsultim me komunitetin bazohet në njohjen që një polici e mbyllur që vendos në mënyrë të njëanshme se cilat janë nevojat e komunitetit nuk do të jetë e suksesshme. *Konsultimi, angazhimi dhe mobilizimi* i komunitetit në identifikimin e problemeve të komunitetit, analizimin e shkaqeve kryesore të problemeve dhe vendosjen e prioriteteve për veprim si dhe implementimin e këtyre veprimeve janë gjithashtu aspekte thelbësore dhe tipar strategjik dallues i qasjes pro-aktive të policimit në komunitet për zgjidhjen e problemeve. Përmes këshillimeve, policia demonstion që shqetësimet, vlerat dhe këshillat e komunitetit do të merren parasysh. Si shkëmbim, komuniteti pritët të japë informacion, burime dhe mbështetje morale për veprimtaritë e policisë. Në fakt, komuniteti duhet të jetë partner aktiv i policisë për evidentimin dhe zgjidhjen e këtyre çështjeve.

*Llogaridhënia dhe transparencia*, që janë gjithashtu parime qendrore të policimit demokratik, kërkojnë që policia të jetë e hapur për vëzhgim të veprimtarisë së saj – përfshirë sjelljen individuale të zyrtarëve policor, strategjive për operacionet policore, procedurave të emërimit dhe menaxhimit të buxhetit – nga një sërë institucionesh mbikëqyrëse. Policia gjithashtu me vullnetin e saj duhet t'i japë publikut informacion dhe garanci. Policia duhet të përgjigjet para ligjit dhe të japë llogari dhe të jetë transparente para publikut. Nëse policia është e gatshme për të qenë transparente rreth operacioneve të saj, atëherë komuniteti ka edhe më shumë gjasa për të qenë më përkrahës përballë problemeve (për shembull sjellje e papërshtatshme nga ana e një zyrtari të policisë, çështja e buxhetit, etj.).

Çështje thelbësore për përkthimin e këtyre parimeve filozofike në praktikë është aplikimi i një sërë strategjive kyçe dhe masave organizative, të cilat përshkruhen në paragrafët e mëposhtëm.<sup>1</sup>



1. Raporti i OSBE për *Përvojat më të mira në ndërtimin e partneriteteve midis policisë dhe komunitetit* (Maj 2008), faqe 19-20. <http://www.osce.org/sq/secretariat/32549?download=true>





## Strategjia e Kosovës për Policimin në Komunitet

Policija Kosova usvojila je Strategiju policije u zajednici 2012-2016 sa ciljem da poveća saradnju izmjeđu stanovnika i policije kroz moto „policija je narod, narod je policija.“ Strategija promovise partnerstvo izmjeđu šire javnosti i policije ohrabrujući njihovu zajedničku odgovornost za pitanja bezbjednosti zajednice. Strategija daje ključnu ulogu forumima za bezbjednost zajednica u identifikovanju, komuniciranju i rješavanju potreba zajednica, i omogućava da ove potrebe postanu ciljevi policije.

## Strategjia e Sigurisë në Komunitet dhe Plani i Veprimit

Strategjia e Sigurisë në Bashkësi dhe Plani i Veprimit 2011-2016 përcaktojnë prioritetet strategjike dhe objektivat e institucioneve të përfshira në sigurinë e komunitetit, siç është parandalimi dhe zvogëlimi i shkallës së kriminalitetit, rritja e pjesëmarrjes publike dhe rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e sigurisë publike, si dhe lehtësimi i procesit të kthimit dhe mbrojtja e komuniteteve. Ajo harmonizon qasjet e tyre dhe koordinon veprimet e tyre, duke e mundësuar realizimin e vizionit të saj për krijimin e një shoqërie shumetnikë të qetë ku njerëzit ndjehen të sigurtë.



## Niveli lokal

Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP) janë organe konsultative që i sjellin së bashku përfaqësuesit lokal të komunitetit, zyrtarët policor, zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e shkollave, si dhe gratë dhe përfaqësuesit e të rinjve që punojnë për përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së jetesës në komunitet. Anëtarët e KLSP-e i ngritin çështje e tilla si krimi, sjelljet asociale, çështjet e mjedisit, si dhe çështje tjera që ndikojnë në sigurinë në komunitet.



## Niveli komunal

Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi (KKS) janë organe komunale që sjellin së bashku përfaqësuesit e institucioneve komunale, policinë, mediat, komunitetet etnike dhe fetare, si dhe organizatat e shoqërisë civile dhe kryetarët e KLSP-ve. Këta këshilla i këshillojnë komunat për çështjet e sigurisë publike, dhe sigurojnë forum për një debat gjithëpërfshirës për sigurinë në komunitet, dhe sigurojnë që nevojat e komuniteteve lokale të bëhen shqetësime të komunës. Ato gjithashtu i ngritin çështjet që KLSP-të nuk mund t'i adresojnë tek autoritetet komunale.



1. RADNA MESTA

\* 2. KVALITETNO OBRAZOVANJE

\* 3. - II - ZDRAVSTV. ZAŠTITA

\* 4. ZDRAVA ŽIVOTNA SREDINA


\* 5. OPŠTU SIGURNOSTI

\* 6. KOMUNIKACIJA SA SVETOM

BEZ OGRANIČENJA (BEZVIZNI REŽIM)

\* 7. BOLJA INFRASTRUKTURA  
U SVIM SEGMENTIMA

\* 8.



## Përfitimet e Komunitetit: nxënësve, prindërve, të moshuarve, komuniteteve lokale, sipërmarrësve privatë, komuniteteve fetare dhe shoqërisë civile

KLSP-të dhe KKSB-të e ngritin zërin si për individët ashtu edhe për grupet e interesit për çështjet e sigurisë në komunitet, duke vepruar si forume ku ato mund të angazhohen dhe të ngritin shqetësimet ose çështjet e sigurisë që në mënyrë pro-aktive të merren me to. Kjo çon në parandalimin dhe reduktimin e kërcënimeve dhe mundëson që një komunitet të jetë i qetë dhe i sigurt. Duke e bërë të mundur zbatimin e projekteve të komunitetit në bazë të nevojave lokale, puna e këtyre forumeve për siguri në komunitet ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e përgjithshme të anëtarëve të komunitetit:

- Studentët dhe të rinjtë kanë një mundësi të veçantë që zëri i tyre të dëgjohej dhe të kontribuojnë për një mjedis më pozitiv.
- Prindërit mund të sugjerojnë projekte që rrisin sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve të tyre.
- Të moshuarit mund ta ofrojnë përvojën e tyre dhe njohurinë mbi mënyrat për ti ngritur çështjet që prekin popullatën më të vjetër.
- Komunitetet e ndryshme mund të përdorin KLSP-të si forum për të komunikuar shqetësimet e tyre të sigurisë, por edhe për të inkurajuar integrimin, procesin e kthimit dhe shkëmbimet pozitive me komunitetin e gjerë.
- Sipërmarrësit privatë mund të përfitojnë nga një mjedis më pozitiv dhe i sigurt për bizneset e tyre, si rezultat i punës së KLSP-ve.
- OJQ-të mund ta përdorin ekspertizën e tyre dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve në takimet e komunitetit në mënyrë që t'i japin larmi qasjes dhe të përqendrohen në fushat e tyre. Partneritet me KLSP-të u lejojnë atyre që të aplikojnë për fondet dhe donacionet për implementimin e projekteve të komunitetit.





## Ndërtimi i partneritetit

Ndërtimi i partneriteteve është element vendimtar për krijimin efektiv të bashkëpunimit midis organeve të ndryshme që punojnë në çështjen e sigurisë në komunitet në Kosovë. Për t'i rritur aftësitë e anëtarëve të KLSP-ve të sapo-formuara në krijimin e partneriteteve të reja në nivel lokal, komunal dhe qendror, Zyra Koordinuese për Siguri në Bashkësi, e mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, i trajnon ato në parimet bazë të bashkëpunimit, pjesëmarrjes, përfshirjes, dhe qëndrueshmërisë.

Përveç kësaj, Takimi i Këshillit Ekzekutiv të KLSP-ve që mbahet 2 herë brenda vitit i lehtësuar nga OSBE-ja, që mbledh anëtarë prej më shumë se 40 KLSP-ve të shtrira në mbarë Kosovën, promovon koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet KLSP-e. Anëtarët diskutojnë mësimet e nxjerra dhe inkurajohen në zbatimin e praktikave më të mira në të ardhmen.





Грачаница - исток  
Сушица / Sushicë  
Кишница / Kishnicë  
Бадовац / Badoo



## Zgjidhja e problemeve

Kur anëtarët e KLSP-e t'i kenë zotëruar aftësitë në ndërtimin e partneritetit dhe të kenë filluar me krijimin e tyre, ato njihen me aftësitë për t'i zgjidhur problemet. Zyra Koordinuese për Siguri në Bashkësi të cilën e mbështet Misioni i OSBE-së në Kosovë i trajnon anëtarët e KLSP-ve për mënyrën sesi ta përdorin modelin SARA në zgjidhjen e problemeve. Modeli SARA është shkurtësë fjalësh nga gjuha angleze (Identifikimi i problemit (ang. Scanning), Analiza e problemit (ang. Analysis), Reagimi ndaj problemit (ang. Response) dhe Vlerësimi i rezultatit në zgjidhjen e problemit (ang. Assessment). Në këtë mënyrë anëtarët e KLSP-ve arrijnë të fitojnë njohuri e cila u ndihmon atyre të merren me çështjen e shkallës

së kriminalitetit, sigurisë dhe cilësisë së jetesës në komunitetet e tyre. Anëtarët e KLSP-ve gjithashtu trajnohen në zhvillimin e planeve të veprimit për projekte që mund të implementohen në kuadër të komunitetit. Duke aplikuar aftësitë e reja KLSP-të janë në gjendje të kontribuojnë në mbrojtjen dhe sigurinë e komuniteteve të tyre në mënyrë të pavarur dhe të qëndrueshme.

## Projektet e komuniteteve

KLSP-të janë në proces të implementimit të një numri të madh të iniciativave për siguri në komunitet, të financuara përmes një projekti trevjeçar të mbështetur edhe nga OSBE-ja dhe Qeveria Norvegjeze. Projekti është i ndarë në tri faza dhe ka një buxhet total prej € 401,604 Euro.





• **Numri total i 31 Iniciativave të KLSP-ve** janë zbatuar në fazën e parë të projektit në vitin 2013, duke përfshirë “Rindërtimin dhe Furnizimin e Qendrës Kulturore” (implementuar nga KLSP-ja e Gushtericës së Poshtme), “Ofrimi i objekteve më të sigurta dhe më të rehatshme për aktivitete në natyrë përmes instalimit të këndit të lojërave” (implementuar nga KLSP-ja e Shipashnicës së Poshtme), “Mbështetja në ndërtimin e kapaciteteve për rininë lokale” (implementuar nga KLSP-ja e Runikut- Bajës-Syriganes, Skenderajit), dhe “Siguria në trafik për Fëmijët e Shkollave dhe Komunitetet” (implementuar nga KLSP-ja në Labjan-Bostan).

• **Numri total prej 22 Iniciativave të KLSP-ve** janë në proces të implementimit në kuadër të fazës së dytë të projektit në vitin 2014, ku përfshijnë “Përmirësimin e kushteve të jetesës për fëmijët me aftësi të kufizuara” (implementuar nga KLSP-ja e Osojan), “Përmirësimi i kushteve të sigurisë brenda oborrit të shkollës lokale” (implementuar nga KLSP-ja e Janjevës), “Përmirësimi i infrastrukturës për sigurinë në komunikacionin” (tri iniciativa të ngjashme në KLSP-në e Vërbocit-Gërçarit, në KLSP-në e Krushevës dhe në KLSP-në e Sushicës, dhe dy kampe rinore shumetnike (implementuar bashkërisht nga KLSP e Shipashnicës së Epërme dhe Shipashnicës së Poshtme, si edhe nga KLSP e Fushë Kosovë).

• **Rreth 25 Iniciativa të KLSP-ve** janë planifikuar të mbështeten në vitin 2015 në fazën e tretë të projektit. Të gjitha KLSP-të janë inkurajuar që të paraqesin ide për iniciativat të fokusuar në përmirësimin e rendit, sigurisë dhe cilësisë së jetesës në komunitetet e tyre për marrjen e fondeve për implementimin e tyre.





## Rezultati

Në dy vitet e fundit, përfaqësues të komuniteteve të ndryshme, duke përfshirë gratë, të rinjtë dhe të moshuarit në mbarë Kosovën kanë përfituar drejtpërdrejt nga iniciativat e KLSP-ve:

- Nëntë shkolla kanë përmirësuar kushtet e tyre të sigurisë përmes vendosjes së rrethojave të oborreve dhe fushave sportive pranë shkollës, ndërtimit të trotuareve brenda oborreve të shkollave, përmirësimit të infrastrukturës sportive të shkollave përmes ndërtimit të fushave sportive;
- Katër komunitete i kanë përmirësuar kushtet mjedisore përmes aktiviteteve të pastrimit siç janë: pastrimi i deponive ilegale të mbeturinave, rrugëve, varrezave, brigjeve të lumit, dhe hapësirave tjera;
- Tri lagje kanë përmirësuar infrastrukturën rrugore përmes shtrimit të zhavorrit në rrugë dhe ndërtimet e shtigjeve për trotuar;
- Dy rrugët janë bërë më të sigurta për ecje gjatë territ përmes nismave të ndriçimit të rrugëve;
- Një komunitet ka përmirësuar kushtet për mbajtjen e ngjarjeve kulturore dhe tubimeve përmes rindërtimit dhe rinovimit të një qendre kulturore, dhe;
- Një park në një fshat është ndërtuar në mënyrë që pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme të mund të shoqërohen dhe organizojnë aktivitete të përbashkëta rekreative.

Përveç kësaj, dhjetë iniciativa ishin të lidhura me programet e trajnimit që lidhen me sigurinë në komunitet, në rritjen e aftësive dhe vetëdijes së të rinjve për sigurinë në trafik, ndihmën e parë, avokimin civil dhe dialogun ndëretnik.





Për të mësuar më shumë rreth policisë në komunitet dhe për të marrë pjesë, ju lutem kontaktoni në:

**192**  
**info@kosovopoliice.com**  
**www.kosovopoliice.com**